

SPECIFIKIMET TEKNIKE*

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

OKSIGJEN MJEKËSOR I LËNGSHËM (BAR)

Formë doza: Gaz per perdorim mjeksor, i lengshem, 1.337g/1L (15°C dhe 1 bar)

I. Përbërësit në përqindje.

Oksigjen	O ₂	minimumi 99,5 %
Monoksid karboni	CO	0,13 vpm (volum për milion)
Bioksid karboni	CO ₂	0,11 vpm
Ujë	H ₂ O	0,06 vpm
Të tjera		mungojnë

II. Kushtet e furnizimit.

Furnizimi bëhet me autobotet e furnizuesit të paisur me leje për:

1. Transport gazra mjekësore nën presion nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial.
2. Transport gazra mjekësore nën presion nga MNZSH.

Tankerat e Oksigjenit

Furnizimi dhe depozitimi i Oksigjenit të lenget do të bëhet në përputhje me kushtet teknike dhe të sigurisë, në tankerat në pikat e përcaktuara nga institucionet spitalore përfituese, të cilat jepen si më poshtë:

Gaz per perdorim mjeksor, i lengshem, 1.337g/1L (15°C dhe 1 bar)

Nr	Institucioni	Sasia totale litra	Nr i tankereve	Kapaciteti në litra	Pronesia
1	QSUT	547,302	1	10.000	Pronesi e QSUT
			2	10.000	Pronesi të operatorit ekonomik
			1	3.000	Pronesi e operatorit ekonomik
			1	5.000	Pronesi e operatorit ekonomik
2	Materniteti "Nëna"	82,000	1	10.000	Pronesi e operatorit ekonomik

	Geraldinë”				
3	Materniteti “Koço Gliozheni”	100,000	1	11.800	Pronesi e Spitalit
4	SU Shefqet Ndroqi	100,000	1	10.000	Pronesi e operatorit ekonomik
5	SUT	102,382	1	10.000	Pronesi e operatorit ekonomik
6	Durres	122,240	1	5.000	Pronesi e Spitalit
7	Elbasan	42,100	1	5.000	Pronesi e Spitalit
8	Shkoder	69,950	1	5.000	Pronesi e Spitalit

Per institucionet te cilat nuk kane ne pronesi tankera, mbeshtetur ne detyrimin per te furnizuar mallin (oksigen i lenget) te ambalazhuar sipas kushteve teknike, Kontraktori duhet te furnizojë dhe montoje prane AK, tankerat te cilat do te jene ne perdorim te institucionit spitalor deri ne perfundimin e kontrates. Kontraktori eshte pergjegjes per kontrollin dhe mirembajtjen e tyre ne perputhje me kushtet teknike dhe legjislacionin ne fuqi.

III. Kerkesa të veçanta

1. Brenda 7 ditëve nga lidhja e kontrates, Operatori Ekonomik fitues, ne marreveshje me institucionin spitalor, duhet të realizojë furnizimin dhe montimin e tankerave te tij (zevendesimin e tankerave te kontraktorit te vjeter) prane AK të cilet nuk i kanë ne pronësi tankerat. Per periudhen e zgjatjes se punimeve, kontraktori duhet te marrë masat për të mos nderprerë furnizimin me oksigen të shërbimeve spitalore, qe perdorin vetem oksigen të lengshëm duke furnizuar më parë rampat e oksigjenit të gaztë me bombola 40 litershe me presion 125 bar, sipas nevojave te spitaleve, me një sasi konsumi ditor si më poshtë:

Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”

- Rampa e Spitalit Onkologjik, 100 bombola 40 litërshe, presion 125 bar,
- Rampa e Spitalit Pediatrik, 40 bombola 40 litërshe, presion 125 bar,
- Rampa e Spitalit Neurokirurgjisë, 40 bombola 40 litërshe, presion 125 bar,
- Rampa e Spitali Ri, 60 bombola 40 litërshe, presion 125 bar,
- Furnizimi normal me autobot tek tankeri pranë spitalit 6-katësh.

Per spitalet e tjera sipas kerkeses se tyre te percaktuar ne kontrate.

Sasia e oksigjenit mjeksor të gaztë të konsumuar gjatë ditëve të instalimit të tankerave do të konvertohet në oksigen të lëngët sipas normativave teknike.

2. Operatori ekonomik duhet te siguroje, ne rast avarie te tankerit te oksigjenit lëng, furnizimin me tanker rezerve ose me bombola oksigjeni mjeksor gaz, në rampat e oksigjenit të gaztë, për te siguruar gatishmerine e furnizimit me oksigen te shërbimeve spitalore. Sasia e

oksigenit mjeksor të gaztë të konsumuar gjatë kesaj periudhe do të konvertohet në oksigjen të lëngët sipas normativave teknike.

- Operatori ekonomik duhet të mbajë gjendje brenda territorit të Shqipërise një sasi rezerve, jo me pak se 50.000 litra oksigjeni mjeksor të lëngshëm, që të mbulojë nevojat 15 ditore të spitaleve. Për këtë, ai duhet të ketë në dispozicion tankera/serbatore/cisterna me kapacitetin e kërkuar.

Afatet e livrimit të oksigjenit të lëngët: fillon nga data e nënshkrimit të kontratës deri në **daten 31.12.2017**.

Furnizimi bëhet sipas grafikut mujor të hartuar nga Spitalet, një kopje e të cilit i jepet furnizuesit në fund të çdo muaji për muajin pasardhës, si dhe konsumit faktik duke lajmëruar furnizuesin dy ditë më parë.

SASIA DHE GRAFIKU I LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Nr	Artikulli dhe formidoza: Gaz oksigjen për përdorim mjeksor, i lëngshëm, 1.337g/1L (15°C dhe 1 bar)		Fondi limit për çdo institucion
	Institucioni	Sasia në litra- lëng	Leke pa tvsh
1	SUT	102,382	14,333,521
2	Elbasan	42,100	5,894,017
3	Materniteti 1	82,000	11,480,033
4	Shkoder	69,950	9,793,028
5	Materniteti 2	100,000	14,000,040
6	Durres	122,240	17,113,649
7	SU Shefqet Ndroqi	100,000	14,000,040
8	QSUT	547,302	76,622,499
	Sasia totale	1,165,974	163,236,826
	Vlera totale		

Afatet e lëvrimit: Sipas Grafikut të lëvrimit të përcaktuar në kontratat e lidhura mes paleve.